



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 5
Prishtinë, më 26 prill 2011, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Muhamet Mustafa, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: Valbon Bytyqi dhe Mujë Gashi – ZAP, Daut Demaku, Liridon Dalipi, Arben Bilalli-KPM dhe Kosum Aliu – NJQHA.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatorë, Musa Rudaku – zyrtar i fushës së ekonomisë dhe i financave, KIPRED (staf mbështetës) - Artan Venhari e Albert Krasniqi dhe Arta Demolli – praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 12.04.2011,
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Pasqyrave Finansiare të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010,
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Pasqyrave Finansiare të Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12 prill 2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 12 prill 2011.

Kryesuesi – Paraqiti vërejte lidhur me atë së pse Raportet e ZAP- it bëhen publike para se këto raporte të diskutohen në Komision dhe në Kuvend. Pastaj raportet financiare shqyrtohen nga komisionet e tjera dhe si të tilla miratohen në Kuvend, pa u shqyrtuar fare në këtë komision. Kjo formë e punës ka ngritur dilema dhe perceptime shumë të gabuara. Propozoj që të gjendet një rrugë në mënyrë që Komisioni të jetë më efektiv në punë. Hap diskutimin.

Armend Zemaj – Tha se kjo ka të bëjë me përkufizimin e fushëveprimtarisë së këtij komisioni. Raporti financiar është dashur të shqyrtohet në këtë komision para se të kalojë në Kuvend. Kompetencat e këtij komisioni duhet të sqarohen. Ishte i mendimit që për secilin raport të formohen grupe punuese për shqyrtimin e tyre.

Ramiz Lladrovci – Tha se Raporti Auditimit të Pasqyrave Financiare është i ndarë nga raporti financiar që është miratuar në Kuvend. Ky komision mund të japë rekomandim dhe të kërkojë pikë të veçantë për shqyrtim në Kuvend lidhur me të gjeturat e ZAP- it.

Mursel Haljilji – Tha se Komisioni nuk duhet të merret vetëm me shqyrtimin e raporteve, por edhe duhet të vendosi lidhur me to. Prandaj mendoi se në rend dite duhet të figurojë edhe miratimi i raportit. Në KPM ka vërtet të gjetura dhe probleme serioze si rreth shpenzimeve, ashtu edhe rreth dyfishimit të pozitive, pastaj shkelja e memorandumit etj. Pra, Komisioni duhet të vendos nëse vetëm do të shqyrtojë këtë raport, ose edhe do të vendosi për shqyrtim në mbledhje plenare.

Muhamet Mustafa- Ka mosharmoni në dinamikën kur Organizatat Buxhetore (OB) paraqesin raportet sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike, në raport me kohën kur bëhet auditimi i këtyre OB. Ndoshta do të ishte mirë që për disa OB të kemi mbledhje të përbashkëta me Komisionin për Buxhet dhe Financa (KBF). Ligji obligon OB- të që të raportojnë për financat publike, nga ana tjetër edhe ZAP-i i drejtohet Komisionit. Kjo duhet të zgjidhet në nivel të Kuvendit, sepse Komisioni nuk mund ta zgjidhë këtë. KBF shqyrton aktivitetin dhe buxhetin e OB- së, a ka pasur tejkalime, ndërsa në këtë komision është rregullsia, si vërtetësia e pasqyrave etj.

Bali Muharremaj- Ndau mendimin me parafolësit dhe propozoi që kryetari i Komisionit të konsultohet me Kryesinë e Kuvendit për të parë se si të veprohet në të ardhmen.

Kryesuesi –Ndoshta duhet t'i drejtohem Kuvendit që këto procese të harmonizohen. Dhe në të ardhmen të kemi edhe mbledhje të përbashkëta me Komisionin për Buxhet dhe Financa. ZAP duhet të kujdeset nëse rekomandimet e ZAP- it po zbatohen ose jo.

Ramiz Lladrovci – Tha se mund t'i drejtohem Kryesisë, ne jemi Komision për Mbikëqyrje të Financave dhe pavarësisht KBF- së, ne shqyrtojmë vetëm pasqyrat e audituara. Domethënë janë pikë e veçantë e rendit të ditës.

Valbona Dibra – Në rastet kur kemi të bëjmë me dy raporte të të njëjtës organizatë buxhetore, atëherë t'i shqyrtojmë të dyja, por në rastet kur nuk ka raporte të audituara, atëherë nuk mund të presim derisa të vijë edhe raporti i auditimit. Është dashur të harmonizohen raportet financiare me raportet e auditorit. Diskutimi i Raportit të Pasqyrave Financiare nga Kuvendi ishte diskutim për raportin se si KPM- ja ka prezantuar pasqyrat financiare. Dhe kjo nuk është punë e dyfishtë, sepse është shumë me rëndësi Raporti i Audituar i Pasqyrave Financiare, sepse ka të bëjë me një raport të auditimit të jashtëm.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Pasqyrave Financiare të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010

Kryesuesi- Lidhur me KPM- në, ZAP- i ka dhënë disa rekomandime. Pikat që duhet qartësuar janë disa. E hapi diskutimin.

Valbon Bytyçi, ZAP- Raporti ka të bëjë me auditimin e rregullsisë të pasqyrave financiare. Në fazën e parë të auditimit jemi fokusuar rreth dizajnit, funksionimit të kontrollit të brendshëm, si dhe regjistrimeve kontabël në përgjithësi. Në fazën e parë të auditimit ne kemi dhënë disa këshilla rreth adresimit të këshillave. Menaxhmenti i KPM- së ka implementuar disa nga këshillat, si p.sh. drejtori i administratës nuk udhëheq më edhe me prokurimin, pastaj auditori i brendshëm nuk merret edhe me menaxhimin e të hyrave. Në fazën e dytë kemi nxjerrë një raport final për KPM- në. KPM nuk ka pasur një auditim të brendshëm. Ka pas dobësi me kontrollin e brendshëm. Nuk është shpalosur përdorimi i fondeve nga Komisioni Evropian në vlerë prej 1.000.000€; nuk dihet ai projekt. Ata nuk kanë të dhëna rreth shpenzimit të këtij një milioni. Prezantimi i Rrogave dhe Pagesave në vlerë prej 202.170€, ku në të njëjtën kohë 118.080€ janë paguar si kompensim në kundërshtim me qëllimin Memorandumit të Mirëkuptimit lidhur me përdorimin e këtyre fondeve; këto mjete kanë qenë të dedikuara për pagesën e ekspertëve jashtë KPM- së. KPM ka paguar punëtorët e saj për punë jashtë orari, por nuk ka evidenca të qarta. Ekzistojnë kode për honorarë. Lidhur me këtë kemi biseduar me KPM- në dhe sipas tyre stafi ka punuar mbas orari dhe pasuritë fikse të shpalosura janë nënvlerësuar për 259.205€. Kjo ka qenë pasojë e KPM- së. Ka edhe të gjetura të tjera të cilat nuk kanë pasur ndikim në pasqyrat financiare. Opinioni i ZAP- it për KPM, është i kundërt.

Daut Demaku, KPM - Ne kemi formuar një komision për të analizuar të gjeturat e ZAP- it. Ky auditim është i pari dhe KPM ka marrë vendim që për të gjitha të gjeturat e ZAP- it të merren masa. KPM është përkushtuar më shumë për performancën duke lënë anash të tjerat. Lidhur me shumën 118.080 euro Këshilli ka marrë vendim që të formojë grupe punuese me bashkëpunëtorë të jashtëm e të brendshme që digjitalizimin ta bëjmë për vijë. Kur është marrë vendimi në Këshill, nuk ka pasur mjete, atëherë kemi bërë një memorandum mirëkuptimi me MEF- in për ta mbuluar këtë. Anëtarët e Këshillit nuk kanë pasur njohuri se çka përmban memorandumin. Ka mundësi interpretimi të ndryshëm. Mjetet janë paguar për punë dhe pavarësisht se a janë punëtoresh të KPM- së ose jo. KPM nuk ka kuadër, prandaj është dashur t'i dyfishojë detyrat. Kemi Udhëzues të BE- së, që 2012 të hyhet në digjitalizim. Ne i pranojmë të gjeturat e ZAP- it dhe do t'i adresojmë ato.

Arben Bilalli, KPM- Tha se KPM ka organizimin e brendshëm i cili është bërë me rekomandim të Kuvendit. Nuk është shpalosur 1 milion euro. KPM nuk ka përgjegjësi për një projekt që ndoshta në fund nuk do të jetë i saj. I kujt është projekti, lidhur me këtë përgjegjës janë IPA dhe MEF- i e Zyra e Kryeministrit, sepse ata janë përgjegjës për bashkëpunimin me IPA. Sa i përket memorandumit me MEF- it, KPM ka memorandum shtesë ku pika 4 plotësohet. Regjistrimi i pasurisë është bërë me vonesë, por janë marrë të gjitha masat lidhur me këtë. Rekomandimet e ZAP- it nuk janë të qarta.

Mursel Haljilji – Pyeti; në f. 5 thuhet që menaxhmenti është detyruar që të angazhohet për adresimin e rekomandimeve. Çka do të thotë se është zotuar? A ju ka dhënë programe, plane apo ka premtuar se do ta bëjë këtë? Raporti është i mangët në këtë aspekt. Në f. 11. ZAP ka konstatuar se KPM ka paguar 2% në emër të ndëshkimeve, ndërsa ligji përcakton 1% në muaj. Lidhur me këtë ZAP në rekomandim ka harruar të konstatojë se këto mjete duhet t'u kthehen njerëzve që u janë marrë në mënyrë të paligjshme. ZAP- ka konstatuar se zyrtari i pasurisë nuk ka njohuri të mjaftueshme. Si keni arritur në këtë përfundim. Po ashtu ZAP ka konstatuar se KPM nuk ka bërë auditim, sepse auditori brendshëm ka punuar diçka tjetër. ZAP është dashur të konstatojë se kush i ka të thënë atij që të punojë diçka tjetër.

Valbona Dibra – Pyeti a ka qenë 1 milionëshi pjesë e buxhetit të KPM- së?

Armend Zemaj – Teknikisht raporti është i pasqyruar mirë. Ka mosqarime në mes të KPM- së dhe ZAP- it. Përgjigja e KPM- së lidhur me proejtkin e KE- së ishte se pa përfunduar projekti ky nuk mund të konsiderohet si projekt i KPM- së, dhe si i tillë nuk mund të shpalolet në pasqyrat financiare të KPM- së. Prandaj, në këtë rast përgjigjja e KPM- së, në kërkesën e auditorit nuk është dhënë me kohë dhe si të tillë auditori e ka paraqitur si të gjetur. Prezntimi i rrogave – asnjë nen nuk e ndalon KPM –në që pjesë e grupeve punuese të jenë punëtorët e KPM-së. Ekziston vendimi i Këshillit të KPM- së, i vitit 2009 kur ka formuar grupet punuese. KPM ka raportuar në MEF dhe kjo është edhe përgjegjësi e MEF- it. Çështjet të cilat u ngritën këtu kanë mundur të rregullohen para se raporti të bëhet publik dhe të shqyrtohet në këtë Komision. Vërejtjet e ZAP- it janë serioze.

Valbona Dibra – “Çdo cent i keqpërdorur gabimisht është vjedhje ndaj një të varfëri”. Prandaj të gjithë duhet të jemi të përgjegjshëm për çdo cent, duke pasur parasysh gjendjen në Kosovë. Vendimi i Këshillit për formimin e grupeve punuese është bërë në vitin 2009, memorandumit është bërë në vitin 2010, i nënshkruar nga KPM- ja dhe MEF-i, atëherë pse kjo nuk është potencuar në memorandum? Pse këto sqarime nuk janë bërë më herët? KPM ka pasur kohë për t’i dhënë të gjitha komentet, madje ka pasur mundësi të kërkoj edhe shtyrje të afatit.

Liridon Dalipi – KPM –ja ka bërë komente, por disa herë janë sugjeruar nga ZAP- i që komentet të jenë sa më të shkurtra dhe për disa pika, jo për të gjitha. Sa i përket taksës 2%, neni 44 i ligjit thotë se parasheh taksën 2%. ZAP- i ju ka referuar ligjit në fund të 2010- ës, ndërsa taksat janë mbledhur në fillim të vitit 2010. Ne ju kemi referuar ligjit në fuqi. Të gjitha rekomandimet e ZAP- it janë marrë për bazë, është zgjidhur problematika e drejtorit të administratës që ka ushtruar edhe detyrën e shefit të prokurimit, pastaj auditori i brendshëm është në zyrë të veçantë dhe nuk merret me punë tjetër, atëherë pse këto nuk janë përfshirë në raportin e ZAP- it. Auditimi është bërë me kërkesën e KPM- së. Buxheti po shpenzohet në fund të vitit. Kjo është për pasojë se Këshilli i KPM-së nuk është i kompletuar. Aktualisht janë vetëm dy anëtarë të Këshillit, e duhet të jenë shtatë. Ne nuk kemi kuorum për të marrë vendime për shpenzime pa kuorum. Ne kemi dorëzuar listën e të nominuarve në Kuvend, por asgjë nuk është bërë në këtë drejtim. Domethënë ne deri tani s’kemi mundur të bëjmë asnjë vendim madhor për shpenzimin e buxhetit pa kuorum. Sa i përket dyfishimit të pozitave, KPM nuk e ka të lejuar të marrë punëtorë. Shumica e stafit kryen detyra shtesë.

Ramiz Lladrovci – Komisionit i intereson nëse ju keni shpenzuar buxhetin konform ligjit ose jo. Rekomandimet duhet të pranohen, sepse duhet shmangur konflikti i interesit në ushtrimin e detyrave. Për punën e KPM- së është miratuar raporti vjetor i punës, por sot diskutohet për pasqyra të audituara financiare.

Mursel Haljilji- Ndau mendimin me deputetin Lladrovci. Qëllimi është që t’u bëhen me dije lëshimet e bëra. Raporti i ZAP- it është i mirë dhe duhet të pranohet me sugjerimet e bëra më herët. KPM duhet të evitojë lëshimet e bëra, dyfishimi i pozitave nuk mund të arsyetohet me faktin se KPM nuk ka pasur staf të mjaftueshëm. Lëshimet nuk mund të amnistohen.

Kryesuesi – Lidhur me çështjen e auditimit KPM ka mundur të kërkojë ndihmë nga MEF- i.

Muhamet Mustafa - Auditorë të brendshëm nuk mund të ketë çdo organizatë, sepse janë të vogla, atëherë ne duhet MEF- it t’i japim rekomandimin që me disa organizata të pavarura të bashkëpunojnë dhe të kenë një auditor të brendshëm të përbashkët, përndryshe është shumë vështirë me pas të gjithë nga një auditor.

Valbon Bytyçi, ZAP –Të gjeturat materiale duhet të prezantohen edhe te pjesa e opinionit, edhe te përmbledhja. Rekomandimet janë të qarta, të matshme dhe të implementueshme. Sa i përket zotimit të implementimit, KPM është zotuar se do t’i implementojnë të gjitha rekomandimet, mirëpo këta e kanë një afat prej 30 ditësh për ta dorëzuar një plan lidhur me implementimin e

rekomandimeve, atëherë plani do të jetë i shkruar dhe në vitin tjetër ZAP do të përcjellë nëse ka arritur ai plan të implementohet.

Te normat e kamatës e gjetura nuk ka qenë ajo materiale dhe për këtë arsye nuk kanë rekomanduar që të kthehen ato mjete.

Zyra e auditorit mundohet që për secilën të gjetur ta gjejë edhe arsyen pse ka ndodhur edhe ndikimin, sa ka pasur ndikim ajo. E gjetura i ka katër elemente, ka kriterin si duhet me qenë e ka gjendjen, shkakun pse ka ndodhur edhe ndikimin sa ka qenë ndikimi i asaj të gjeture. Auditori i brendshëm dihet që nuk mund të merret me punë operative në organizatë. Është një vendim i KPM- së, që është bërë në 2009 dhe i ka caktuar se cilat grupe punuese marrin pjesë, normalisht që kanë pasur të marrin pjesë edhe anëtarët e KPM- së, mirëpo në ato grupe punuese në vendim parashihihen të kishin pasur ekspertë të të gjitha fushave, më vonë ka ardhur memorandum ku ceket shumë qartë, se nga këto mjete nuk duhet paguar asnjë punëtor i KPM- së.

Te prokurimi ishte pyetja a mund të kërkohej informata shtesë, me ligj lejohet që të kërkohej informata shtesë, mirëpo jo informata që nuk parashihihen në dosje të tenderit, mirëpo këta e kanë vlerësuar si tender të ulët. Rreth bashkëpunimit, unë kam marrë pjesë në takime edhe kemi diskutuar edhe mbas takimeve. Komentet duhet me qenë konkrete edhe të kenë pasur dëshmi shtesë lidhur me komentin. Realizimi i buxhetit edhe këtu është i njëjtë sikur në të gjitha organizatat e tjera që në tre mujorin e fundit shpenzimet janë më të mëdha, edhe në këtë organizatë është e njëjta situatë.

Valbona Dibra – Tha se raporti i ZAP-it është shumë profesional, dhe ky raport duhet të procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare. Të gjeturat ekzistojnë dhe ne si deputetet jemi përgjegjës për shpenzimin e parasë publike. Ne si Komision nuk duhet të bëjmë tolerime kur janë gjithë këto të gjetura në KPM.

Mursel Haljilji – Propozoi që Kuvendi të vendos për raportin e ZAP-it, dhe çfarë masash do të ndërmerren apo nuk do të ndërmerren.

Armend Zemaj – Komisioni duhet të nxjerr rekomandime të cilat duhet t'i paraqes Kuvendit dhe në bazë të atyre rekomandimeve orientohet edhe diskutimi në mbledhje plenare.

Muhamet Mustafa- Propozoi që raporti i ZAP-it të miratohet me plotësimet të cilat dolën në Komision dhe të obligohet KPM që brenda një periudhe të evitoj të gjeturat dhe të raportoj për veprimet e ndërmarra.

Kryesuesi - Tha se të gjitha këto janë edhe një argument plus që raportet duhet të shqyrtohen këtu bashkërisht në ballafaqim me faktet dhe më pastaj të del ne opinion. Memorandumi është më i vonshëm se sa proceset që kanë ndodhur, elementi i dytë është se sa janë përgjegjës KPM-ja përgjegjëse është edhe MEF-i. Komisioni nuk do të amnistoj asnjërin.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Raporti me rekomandime i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, lidhur me auditimin e Pasqyrave Financiare të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010- të.
2. Detyrohet Komisioni i Pavarur për Media, që në afatin brenda gjashtëdhjetë ditësh, nga dita e miratimit të këtij raporti, përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, të njoftoj Kuvendin për veprimet e ndërmarra në përmbushjen e rekomandimeve të ZAP-it.

3. *Kuvendi të ndërmarrë veprimet e nevojshme për kompletimin e Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media.*

4. *Arsyetimin e Rekomandimit e paraqet, deputeti Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.*

4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Pasqyrave Financiare të Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010

Mujë Gashi – ZAP- ZRRUM, pasqyrat financiare të Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina, për vitin 2010, pasqyrojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë. ZAP ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar si, mos evidentimi i plotë i pasurisë me të cilën disponon ZRRUM nuk i mundëson menaxhmentit të ketë gjendjen e plotë dhe të saktë mbi pasurinë. Mungesa e evidencave të sakta mbi pasurinë që ka në pronësi rregullatori ka ndikuar në prezantimin jo të plotë të saj në pasqyrat financiare dhe kjo e ekspozon ZRRUM-in para rrezikut të humbjes ose keqpërdorimit të pasurive publike. ZAP ka identifikuar mos efikasitet në inkasimin e të hyrave. Pastaj furnizim në kundërshtim me kontratën, certifikim me dokumentacion të pakompletuar, mos mbajtja e evidencave vetanake për furnizim, mos mbajtja e evidencave për hyrje daljet të mallit në depo. Te gjeturat e identifikuar janë rezultat i mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme. Pastaj kontroll i pamjaftueshëm mbi procedurat e rekrutimit, performancë e ulët në funksionimin e Komisioneve Konsultative të Konsumatorëve (KKK), menaxhim dhe mirëmbajtje të automjeteve pa kontratë, shpenzime në kundërshtim me rregullat financiare – pra ZRRUM nuk ka kontrolle të brendshme për menaxhimin e parasë së imët. Sistem jo efikas në inkasimin e të hyrave – vlera është rreth 30% e buxhetit final. Regjistrimi i pasurisë nuk është i plotë dhe i saktë – pra pasuritë nuk janë menaxhuar në pajtim me kornizën rregullative, si dhe kontrolli i brendshëm është jo funksional.

Raif Preteni – ZRRUM – Tha se ka një marrëveshje me Departamentin e Thesarit lidhur me decentralizimin e pagesave dhe zbatimi i kësaj marrëveshje ka filluar me një trajnim nga ana e thesarit në fund të vitit 2010. ZRRUM ka parashtruar kërkesë në MEF për një auditim të brendshëm në ZRRUM dhe kjo është bërë. Të gjeturat e ZAP- it janë të pranueshme dhe zotohemi se do t'i zbatojmë me përpikëri. E vetmja problematik ligjore është te inkasimi ku sipas ligji thuhet nuk ke të drejtë t'i marrësh licencën një kompanie, përpos nëse nuk ka ndonjë alternativë tjetër. Alternativë tjetër nuk ka. Nuk jemi të kënaqur me shkallën e inkasimit. Rekrutimi i stafit - personeli ka një zyrtar, nuk ka menaxher, por me këtë merret shefi i administratës.

Valbona Dibra – Komentoi rëndësinë e ZAP- it, që në rastin konkret një zyrtar e ZRRUM- it nuk ka qenë mirë e informuar dhe nuk ka dhënë informata të sakta ose të nevojshme për auditorin, herave të tjera duhet të jenë të përgatitur dhe të informuar mirë.

Afrim Hoti – Tha se në f.11 të raportit flitet për parregullsi rreth menaxhimit dhe rekrutimit të stafit si, mos nënshkrimi i kontratave nga menaxheret e personelit, dosje të pakompletuara ose caktohet vendimi i komisioneve intervistuese ende pa u shpallur konkursi dhe parregullsi të tjera, por këto parregullsi hapin rrugë automatikisht për korrupsion. Pyeti: këto raporte a mund të shkojnë në gjykatë në mënyrë që të parandalohen këto keq menaxhime, konkretisht çka ka bërë ZAP- i në këtë drejtim?

Mursel Haljilji – Tha se shuma e inkasuar dhe e faturuar kanë dallime shumë të mëdha dhe kjo krijon probleme për Buxhetin e Kosovës. Propozoi që pagesa për këto shërbime të bëhet përmes bankave. P.sh. nëse nuk ka numër të mjaftueshëm të inkasantëve, atëherë qytetari të mos presë inkasantin por ta bëjë pagesën përmes banke.

Ramiz Lladrovci – Pyeti: gjatë vlerësimeve të punëtorëve në fund të vitit a vlerësohen me nota të larta ata që kanë bërë gabime? Sepse me një vlerësim të ZRRUM- it ata mund të konkurrojnë në ndonjë pozitë më të lartë kështu që i jepni mundësinë për të bërë gabime edhe më të mëdha.

Armend Zemaj – Tha se duhet fokusuar në çështjen e inkasimit. Arsyeshmëria që ata nuk kanë kapacitete ose nuk kanë mundësi buxhetore për të paguar licenca dhe arsye pse ju vazhdohet licenca, këtu mund të preken këto çështje. Cilat janë masat që janë marrë nga ZRRUM në këtë drejtim?

Ramiz Lladrovci – Tha se ZRRUM ka të drejtë për të bërë kërkesë për rritjen e numrit të stafit në Komisionin për Buxhet dhe Financa, por edhe në këtë Komision, ku mund të diskutohet kuptohet me një arsyeshmëri më të mirë, sesa kjo që e kemi deri më tani.

Mujë Gashi, ZAP - Çështjet që kanë të bëjnë me dosje janë çështje që kanë të bëjnë me mos kujdesin e duhur që ka treguar zyrtarja, por ndoshta edhe menaxhmenti është dashur të ketë kujdes rreth kompletimit të tyre për shkak se është kërkesë në bazë të ligjit që për të qenë staf duhet për ta pasur të kompletuar dosjen. Dhe kjo është më shumë në aspektin e funksionimit të kontrollit të brendshëm dhe rritjes së kujdesit të këtyre çështjeve. Çështja tjetër ka të bëjë me faturimin dhe inkasimin, ne e kemi adresuar këtë çështje dhe menaxhmenti e ka kuptuar drejt. Ka pasur problem rreth funksionimit të kompanive të mbeturinave që është një imperativ që duhet të ketë për shkak se në aspektin e funksionimit, ne e kemi thënë edhe më herët ZRRUM- it se nuk është çështja buxhetore që e ka zyra e rregullatorit në aspektin e rregullimit të furnizimit me ujë dhe mbeturina se si i licencën kompanitë dhe se si monitoron kompanitë për licencimin e tyre. Çështja tjetër që e kemi adresuar është që menaxhmenti të bëjë përpjekje të zhvilloj edhe më tutje instruksione dhe procedura të qarta që do të ndihmonin në adresimin e gjetjeve.

Raif Preteni, ZRRUM- Vendimi për panelin intervistues - në atë kohë zyrtari që merret me çështjen e personelit ka qenë në pushim vjetor. Çështja e diplomës, në këtë kohë zyrtarja e ka pasur diplomën në Kroaci për regjistrim në master dhe nuk ka pasur kopje të diplomës, mirëpo tani kjo është rregulluar. Shpenzimet për këshillat e konsumatorëve - në bazë të ligjit jemi të obliguar që të formojmë dhe të paguhen në shumë minimale prej 25 euro në muaj. Ata janë më shumë këshilla vullnetare dhe realisht as ne nuk kemi qenë të kënaqur me punën e këshillit të konsumatorit për atë arsye kemi bërë në muajin e tretë të këtë viti amendamentimin e rregullit të këshillit të konsumatorëve. Licencat për kompanitë rajonale të mbeturinave ka problem në inkasim. Unë kam lëshuar leje me kusht plotësues deri në muajin e gjashtë, nëse ata nuk i kryejnë obligimet që i kanë për licencimin atëherë sigurisht që ne do të mendojmë me ua marrë licencat edhe ato kompani, në bazë të ligjit, duhet të shkarkojnë bordin, por normalisht nëse ndërmarrim një hap të tillë jemi të obliguar të konsultohemi me ministrin e Zhvillimit Ekonomik edhe me Kuvendin e Republikës së Kosovës. Në vitin e fundit kemi bërë kërkesë për shtimin e tre personave të stafit. Kuvendi i Kosovës e ka miratuar këtë kërkesë. Ne e kemi dërguar në MEF, ku na është thënë se nuk kemi buxhet dhe për këtë arsye kemi mbetur me këtë numër të stafit dhe një zyrtarë i kryen pesë funksione.

Kryesuesi - Fatmirësisht të gjeturat në ZRRUM janë më pak se të KPM-ja, rekomandimet janë dhënë dhe janë marrë obligimet që të përgjigjen në ato rekomandime.

Armend Zemaj – Propozoi që raporti të mos procedohet në seancë.

Kryesuesi - Konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. *Miratohet Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare të Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.*
2. *Raporti nuk procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.*

Mbledhja përfundoi në orën 15:20.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu